

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
BASHKINË BURREL

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Bashkinë Burrel**, me objekt: “Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, aktivitetin ekonomik e financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve të qëndrueshme, dhënien me qira të objekteve, funksionimi i policisë, prokurimet me fonde publike, taksat dhe tarifatat vendore, etj.”, lloji i auditimit: “Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri 30.06.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 135, datë 24.09.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 620/8, datë 26.9.2014, i ka rekomanduar znj. Adelina Farrici, Kryetare e Bashkisë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Është konstatuar se sektori i financës së Bashkisë Burrel nuk ka marrë masa për arkëtimin e detyrimeve të rekomanduara më parë nga KLSH-ja, në kundërshtim me ligjin nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshime në ligjin nr. 8599, datë 01.01.2000, me nenin 10 të ligjit nr.10279 dt 20.05.2010 “Për kundërvajtjen administrative “ dhe me nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës “, i ndryshuar.

1.1 Rekomandimi:Drejtoria e Financës e Bashkisë Burrel të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve të rekomanduara nga auditivi i mëparshëm kryer nga KLSH.

Deri me 31.12.2014

2.Gjetje nga auditimi: Është konstatuar se Bashkia Burrel ka bërë padrejtëisht largime nga puna të disa punonjësve të bashkisë dhe njërive vartëse, të cilët kanë fituar të drejtën e pagës për periudhën e shkëputur, çka ka krijuar efekte financiare me ndikim negativ në buxhetin e bashkisë, dhe ndaj fajtorëve nuk është nxjerrë përgjegjësia, në kundërshtim me kërkesat e udhëzimit nr. 4, datë 27.01.2011 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011” pika 6.1 “Vendimet gjyqësore” dhe pika 62 e UMF nr. 2 datë 6.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

2.1 Rekomandimi: Bashkia Burrel të marrë masa dhe të përgatitë material të veçantë mbi largimet nga puna të disa punonjësve të administratës së bashkisë dhe njërive vartëse, shkaqet e largimeve të tyre duke evidentuar efektet negative financiare në buxhetin e bashkisë, si dhe të marrë masa që raste të kësaj natyre mos të përsëriten.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Bashkinë Burrel dhe INUV, nuk kanë bashkëpunuar me institucionet e zbatimit të ligjit për prishjen e ndërtimeve pa leje, lirimin e hapësirave publike, (oborre shkollash, trotuare etj), si dhe nuk ka vendosur sanksione ligjore, sipas kërkesave të nenit 75 dhe 77 të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën” dhe nenit 5/b dhe d të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit”.

3.1 Rekomandimi: INUV në Bashkinë Burrel në bashkëpunim me institucionet e zbatimit të ligjit, të marrë masa për prishjen e ndërtimeve pa leje, lirimin e hapësirave publike, (si oborre

shkollash, trotuare etj), si dhe të vendosë sanksione ligjore për kundravajtjet e kryera nga këta subjekte.

Në Vijimësi

4. Gjetje nga auditimi:

INUV dhe Bashkisë Burrel nuk kanë marrë masa dhe nuk kanë ndjekur procedurat ligjore, për arkëtimin e gjobave në vlerën 1,318,000 lekë, në kundërshtim me nenin 16, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve “ , i ndryshuar, dhe pikën 16 të VKM nr.862, datë 05.12.2007 “Për verifikimin e procedurave të kontrollit nga Inspektoriati Ndërtimit Urbanistik Kombëtar e ai Vendor”.

4.1 Rekomandimi: INUV i Bashkisë Burrel të marrë masa dhe të ndjekë procedurat administrative dhe ligjore, për arkëtimin e gjobave në vlerën **1,318,000 lekë**.

Deri 31.12. 2014

5. Gjetje nga auditimi: Policia Bashkiake nuk ka marrë masa dhe nuk ka ndjekë procedurat ligjore e përmbare, për arkëtimin e gjobave për vlerën 50,460 lekë, duke mos zbatuar nenin 14, pika 2 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe nenet 9,22 dhe 30 të ligjit nr. 10299, datë 20.04.2010 “Për kundravajtjet administrative”.

5.1 Rekomandimi: Policia Bashkiake e Bashkisë Burrel të marrë masa dhe të ndjekë procedurat ligjore e përmbare, për arkëtimin e gjobave për vlerën **50,460 lekë**.

Deri 31.12. 2014

6.Gjetje nga auditimi: Bashkia Burrel nuk ka hartuar planin për ngritjen e plotë të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, planin strategjik, që të përcaktojë objektivat dhe të hartojë planin e veprimeve afatshkurta, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Nuk ka hartuar strategjinë e zhvillimit ekonomik dhe sektorial, nuk ka organizuar dhe funksionimin e ekipeve përkatëse të menaxhimit, si dhe nuk ka marrë në konsideratë këto dokumente për hartimin e PB-ve dhe PBA-ve, në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor”.

6.1 Rekomandimi: Bashkia Burrel të hartojë planin për ngritjen e plotë të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, planin strategjik, të përcaktojë objektivat dhe të hartojë plan veprimet afatshkurta, si dhe të hartojë strategjinë e zhvillimit ekonomik dhe sektorial, të organizojë dhe funksionimin e ekipeve përkatëse të menaxhimit, duke marrë në konsideratë këto dokumente, për hartimin e PB-ve dhe PBA-ve.

Deri 31.12. 2014

7. Gjetje nga auditimi: Bashkia Burrel, nuk ka rishikuar dhe hartuar Rregulloren e Brendshme, sipas funksioneve të strukturave vartëse dhe organigramës së Bashkisë, në përputhje me strukturën organizative dhe nuk ka përcaktuar detyrat e punonjësve të bashkisë, të harmonizuara me vendet e punës, në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 dhe nr. 10296, datë 8.7.2010. Nuk ka siguruar zbatimin e procedurave lidhur me përgatitjen dhe hartimin e projekt buxheteve në kohë, në përmbushje të gjithë funksioneve, për llogaritje saktë e të argumentuar të shpenzimeve të buxhetit nga të ardhurat nga asetet dhe resurset, si dhe nuk ka siguruar evidentimin në kontabilitet dhe ndjekjen e saktë për realizimin e buxhetit, sipas kërkesave të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

7.1 Rekomandimi: Bashkia Burrel, të rishikojë Rregulloren e Brendshme, sipas funksioneve të strukturave vartëse dhe organigramës së Bashkisë, në përputhje me strukturën organizative dhe të përcaktojë detyrat e punonjësve të bashkisë, të harmonizuara me vendet e punës, në zbatim të

ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 dhe nr. 10296, datë 8.7.2010. Të sigurohet zbatimi i procedurave lidhur me përgatitjen dhe hartimin e projekt buxheteve në kohë, në përmbushje të të gjithë funksioneve, për llogaritje saktë e të argumentuar të shpenzimeve të buxhetit nga të ardhurat, si dhe të sigurohet evidentimi në kontabilitet dhe një ndjekje e saktë për realizimin e tij.

Në Vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Financës nuk ka marrë masa, në bashkëpunim me drejtoritë e tjera për të krijuar regjistrin e Aktiveve të Qëndrueshme, ku të përcaktohen të dhënat e nevojshme si: data e hyrjes apo marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes nga përdorimi, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale në rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimit të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia, në zbatim të kapitullit III, pika 30 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

8.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa, në bashkëpunim me drejtoritë e tjera për të krijuar regjistrin e aktiveve të qëndrueshme, ku të përcaktohen të dhënat e nevojshme si: data e hyrjes apo marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes nga përdorimi, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale në rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimit të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia institucionit.

Deri 31.12. 2014

9. Gjetjet nga auditimi: Bashkia Burrel nuk ka marrë masa për arkëtimin e vlerës totale 943,400 lekë nga subjekti “Frederik Pali” për mos pagesë qiraje që i përket objektit “Tregu Industrial”, si dhe nuk ka ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore, nga të cilat 70,620 lekë janë diferencë qiraje nga viti 2012 dhe vlera tjetër 872,780 lekë është qira për periudhën 1 Janar 2014 deri 30 Qershor 2014, në të kundërt nuk ka ndërprer kontratën.

9.1 Rekomandimi: Bashkia Burrel të marrë masa, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore, për arkëtimin e shumës totale **943,400 lekë** nga subjekti “F.P.”, në të kundërt të ndërpritet kontrata dhe të kryhen procedurat e konkurimit publik.

Deri 31.10.2014

10. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Financës e Bashkisë Burrel, nuk ka marrë masa, për të siguruar dokumentacionin dhe nuk ka ndjekur të gjitha hapat ligjore dhe administrative, për arkëtimin e detyrimeve të evidentuara në llogarinë 429 “Personeli paradhënie deficite gjoba” në shumën 15,409,880 lekë, e përbërë nga:

-gjoba të vendosura para vitit 2000 në shumën 2,216,124 lekë për të cilët mungon dokumentacioni bazë i evidentimit si debitorë.

-gjoba në shumën 1,042,325 lekë vendosura sipas rekomandimeve të KLSH në vitin 2011.

- mos arkëtimin e të ardhurave nga tatim taksat që kanë vlerën 12,151,431 lekë.

10.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës e Bashkisë Burrel, të marrë masa për të siguruar dokumentacionin dhe për të ndjekur të gjitha hapat ligjore dhe administrative, për arkëtimin e detyrimeve të evidentuara në llogarinë 429 “Personeli paradhënie deficite gjoba” në shumën 15,409,880 lekë.

Deri 31.12. 2014

11. Gjetje nga auditimi: Sektori i Financës së Bashkisë Burrel nuk ka kryer sistemimin e gjendjes në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” në shumën 335,495 lekë, që përbëhet kryesisht nga detyrime të kontabilizuara e të mbartura prej vitesh, për zhdëmtime e pagesa të tepërta, për të cilat mungon dokumentacioni bazë.

11.1 Rekomandimi: Sektori i Financës të paraqesë një analizë të plotë të historikut të kësaj gjendje llogarie për shqyrtim e vendimmarrje në Këshillin Bashkiak, duke evidentuar përgjegjësinë dhe të kryhen sistemimet e nevojshme kontabile në llogarinë 468 “*Debitorë të ndryshëm*” në shumën 335,495 lekë.

Deri 31.12. 2014

12.Gjetjet nga auditimi: Bashkia Burrel nuk ka ndjekur me përparësi arkëtimi i qirasë të objekteve sipas listës, që fillon me nr. 485 dhe mbaron me nr. 659, gjithsej 195 prona troje me sipërfaqe 83,846 m², si dhe nga 6 pronat pasqyruar në fletën me nr. 660 deri nr. 665, truall+ndërtesë me sipërfaqe 532 m², ku kanë rezultuar të ardhura të munguara në vlerën totale vjetore **30,822,960 lekë**. Nuk ka marrë masa që të ardhurat nga qiratë të parashikohen saktë e të argumentohen nga drejtoritë përkatëse për të propozuar e miratuar paketën fiskale sa më të saktë nga Këshilli i Bashkisë, të bazuar në numrin e saktë të objekteve të programuar.

12.1 Rekomandimi: Bashkia Burrel të ngrejë grup pune i cili të evidentojë e të ndjekë me përparësi arkëtimin e qirasë së objekteve në vlerën totale vjetore 30,822,960 lekë, sipas listës, që fillon me nr. 485 dhe mbaron me nr. 659, gjithsej 195 prona troje me sipërfaqe 83,846 m² si dhe nga 6 pronat pasqyruar me në fletën me nr. 660 deri nr. 665, truall+ndërtesë me sipërfaqe 532 m², ku rezultojnë të ardhura të munguara Të merren masa që të ardhurat nga qiratë të parashikohen saktë e të argumentohen nga drejtoritë përkatëse për të miratuar paketën fiskale nga Këshilli i Bashkisë, të bazuar në numrin e saktë të objekteve të programuar.

Deri 31.12.2014

13. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Shërbimeve nuk ka rishikuar dhe nuk ka vendosë normativat e konsumit të karburantit, duke u bazuar në librezat dhe kapacitetin e mjetit, volumin e cilindrave dhe distancën e rrugës në udhëtim brenda dhe jashtë qytetit. Nuk ka hartuar fletët e udhëtimet ditore dhe nuk janë shënuar e nënshkruar nga personat udhëtues kilometrat e përshkruar për çdo udhëtim sipas distancave ndërmjet qyteteve të të miratuara nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës “*Për distancat rrugore ndërmjet qyteteve*”.

13.1 Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve të rishikojë dhe të vendosë normativat e konsumit të karburantit, sipas kërkesave ligjore dhe të hartojë dokumentacionin e plotë për lëvizjen e mjeteve sipas distancave të miratuara nga MTI sipas tabelave të miratuara nga “*Për distancat rrugore ndërmjet qyteteve*”.

Deri 31.10. 2014

14. Gjetje nga auditimi: Bashkia Burrel nuk ka hartuar dhe zbatuar programin vjetor të kryerjes së inventarizimit të plotë fizik, teknik e identifikues të aseteve në pronësi përdorim dhe juridiksion të Bashkisë, troje, ndërtesa (*pasuri te përfshirë në Listat paraprake për transferim*), nuk ka hartuar listat përfundimtare, si dhe nuk ka ndjekë me Ministrinë e Brendshme miratimin e tyre.

14.1 Rekomandimi: Bashkia Burrel të hartojë dhe të zbatojë programin vjetor të kryerjes së inventarizimit të plotë fizik, teknik dhe identifikues të aseteve në pronësi përdorim dhe juridiksion të Bashkisë, troje, ndërtesa (*pasuri te përfshirë në Listat paraprake për transferim*), të hartojë listat përfundimtare dhe të ndjekë me Ministrinë e Brendshme miratimin e tyre.

Deri 31.12. 2014

15. Gjetjet nga auditimi: Bashkia Burrel, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor në rastet kur ka konstatuar mangësi në dokumentacionin teknik të operatorëve pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, nuk ka kërkuar nga operatorët ekonomik, sqarime për këto mangësi, për të shqyrtuar dhe krahasuar ofertat e tyre sa më drejtë në raport me ofertat e tjera, në zbatim të pikës 1 dhe 4 të nenit 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin Publik*”.

15.1 Rekomandimi: Bashkia Burrel, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor në rastet kur konstaton mangësi në dokumentacionin teknik të operatoreve pjesëmarrës në procedurat e prokurimit

publik, të kërkojë nga operatorët ekonomik sqarime për këto mangësi, për të shqyrtuar dhe krahasuar ofertat e tyre sa më drejtë e me objektivitet.

Në Vijimësi

MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bashkia Burrel të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme ligjore dhe administrative në të gjitha shkallët e gjykimit e ato përmbarimor, me qëllim arkëtimin e vlerës **4,251,049 lekë**, përkatësisht:

1. Gjetje nga auditimi:

Bashkia Burrel ka paguar padrejtësisht subjektin “K...” shpk, sipërmarrës i shërbimit të pastrimit të qytetit, për 2 zëra punimesh, përkatësisht: “*Largim i mbetjeve solide, inerte*” dhe “*Larje speciale e rrugëve*”, për periudhën 2012-2013 dhe 6-mujori i parë 2014, për vlerën 3,921,049 lekë, pagesë kjo në kundërshtim me ligjin nr. 8094, datë 21.03.1996 “*Për largimin publik të mbeturinave*” Kreun II-të neni 6 pika 1-10, neni 5 “Mbeturinat” dhe Kreun III-të, neni 18 “Lagia e zonave të pastrimit”.

1.1 Rekomandimi: Për **vlerën 3,921,049 lekë**, nga subjekti “K...” shpk, duke bërë dhe ndalesa pjesore në pagesat që do të kryhen këtij subjekti nga Bashkia Burrel për shërbimin e pastrimit.

Deri 31.03. 2015

2. Gjetjet nga auditimi: Sektori i Financës ka likuiduar padrejtësisht vlerën 330,000 lekë, për përfitim dieta pa dokumentacionin e kërkuar nga futbollistët e ekipit Burrelit, pasi mungon dokumenti i hotelit me kasë elektronike, në kundërshtim me nënpikën 3.2 të VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “*Për trajtimin financiar të punonjëset që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit*”, sipas urdhër shpenzimit nr. 44, datë 23.2.2012, nr. 150, datë 18.5.2012 dhe nr. 173, datë 14.6.2012, sipas listës bashkëngjitur urdhër shpenzimeve përkatëse.

2.1 Rekomandimi: Për **vlerën 330,000 lekë**, të kërkohet plotësimi i dokumentacionit ose në të kundërt të zhdëmtohet nga futbollistët e ekipit Burrelit sipas listave bashkëngjitur urdhër shpenzimeve përkatëse.

Deri 31.12. 2014

MASA DISIPLINORE

I. Mbështetur në nenin 25 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “*Statusi i nëpunësit civil*”, në VKM nr. 306, datë 13.6.2000 “*Për disiplinën në shërbimin civil*”, si dhe kontratave individuale të punës, në nenin 44, të ligjit nr. 8652, datë 31/7/2000 “*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*”, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore për punonjësit , si më poshtë:

a. Lihet në kompetencën e kryetares së Bashkisë Burrel, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, dhënia e masave disiplinore dhe ndjekja e të gjitha procedurave administrative, për personat e mëposhtëm për detyrat funksionale dhe në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, përkatësisht për:

1. R.K., (jurist) me detyrë sekretar i Bashkisë dhe në cilësinë e kryetarit të KVO, për shkeljet e mëposhtme:

-Në procedurat e prokurimit me objekt: “*Rikonstruksion i Kompleksit të Lodrave Burrel*”, me fond limit në vlerën 58,506,669 lekë, dhe “*Rikonstruksioni i Bllokut Lagja ”Pjeter Budi*”,

Burrel, me fond limit në vlerën 14,141,594 lekë, me cilesinë e kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ka përdorur në kundërshtim me nenin 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” dy standarde të ndryshme, në vlerësimin e kritereve të kualifikim-pranimin të operatorëve ekonomik pjesëmarrës në këto procedura prokurimi. Nga pasoja e këtij veprimi nuk është përmbushur qëllimin kryesor i këtij ligji në lidhje me mirëpërdorimi i fondeve publike, kursimin e tyre dhe sigurimin e trajtimit të barabartë dhe jo diskriminues të operatoreve ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, duke bërë që, vlera 27,244,160 lekë fonde buxhetore të mospërdoren me efektivitet dhe të mos kursehen në favor të buxhetit të shtetit.

2. K.P., (jurist) me detyrë drejtor i shërbimeve të Bashkisë dhe në cilësinë e anëtarit të KVO, si dhe në detyrën e ish-përgjegjës të zyrës së pronave, për shkeljet e mëposhtme:

-Në procedurat e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i Kompleksit të Lodrave Burrel”, me fond limit në vlerën 58,506,669 lekë, dhe “Rikonstruksioni i Bllokut Lagja ”Pjeter Budi”, Burrel, me fond limit në vlerën 14,141,594 lekë, me cilesinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ka përdorur në kundërshtim me nenin 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” dy standarde të ndryshme në vlerësimin e kritereve të kualifikim-pranimin të operatorëve ekonomik pjesëmarrës në këto procedura prokurimi. Nga pasoja e këtij veprimi nuk është përmbushur qëllimin kryesor i këtij ligji në lidhje me mirëpërdorimi i fondeve publike, kursimin e tyre dhe sigurimin e trajtimit të barabartë dhe jo diskriminues të operatoreve ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, duke bërë që, vlera 27,244,160 lekë fonde buxhetore të mospërdoren me efektivitet dhe të mos kursehen në favor të buxhetit të shtetit.

-Për moszbatim të plotë të udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 kreu II pika 30 “Regjistri i aktiveve”, kreu IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve” si dhe “Procesi i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësi” pikat 95, 96 dhe 109, në kryerjen e inventarëve të aktiveve për vitet 2011 dhe 2012.

-Për lejimin e pagesës të paligjshme për vlerën 3,921,049 lekë, për “K...” shpk, sipërmarrës i shërbimit të pastrimit të qytetit, për periudhën 2012-2013 dhe 6-mujori i parë 2014, pasi janë paguar padrejtësisht 2 zëra punimesh, përkatësisht: “Largim i mbetjeve solide, inerte” dhe “Larje speciale e rrugëve”, në kundërshtim me ligjin nr. 8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave” Kreun II-të neni 6 pika 1-10, neni 5 “Mbeturinat” dhe Kreun III-të, neni 18 “Lagia e zonave të pastrimit”.

-Për mos zbatim të detyrave sipas neneve 12 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe rregulloren e funksionimit të aparatit të bashkisë, si kryetar i komisionit për vlerësimin e vlerave materiale për vitet 2012-2013.

-Për mos vjeljen e qirase në total për vlerën 943,400 lekë nga të cilat 70,620 lekë diferencë qiraje nga viti 2012 dhe 872,780 lekë qira e pa paguar dhe kamatë vonesa për periudhën 1 Janar 2014 deri 30 Qershor 2014, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 529 datë 3.1.2012 “Për përcaktimi e kritereve të procedurës dhe mënyrën e dhënies me qira, enftëozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore”. Bazuar në nenin 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues” germa “d”, “dh”, “e” të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” për mos azhurnim të aseteve dhe mos vlerësimin dhe mos regjistrimin e pronave të Bashkisë në regjistra, në kontabilitet dhe pranë ZVRPP Burrel, mos derdhjen në afatin e përcaktuar në kontratë të detyrimit mujor të qirasë, mos kryerjen sistematikisht përlllogaritjen e kamatë vonesave dhe ndjekin derdhjen e tyre sipas rregullave financiare sipas dokumenteve të administruar.

3. V.B., (financiere) me detyrë specialiste në sektorin e Financës të Bashkisë dhe në cilësinë e anëtares të KVO, për shkeljet e mëposhtme:

-Në procedurat e prokurimit me objekt: “*Rikonstruksion i Kompleksit të Lodrave Burrel*”, me fond limit në vlerën 58,506,669 lekë, dhe “*Rikonstruksioni i Bllokut Lagja ”Pjeter Budi*”, Burrel, me fond limit në vlerën 14,141,594 lekë, me cilesinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ka përdorur në kundërshtim me nenin 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin Publik*” dy standarde të ndryshme në vlerësimin e kriteret të kualifikim-pranimit të operatorëve ekonomik pjesëmarrës në këto procedura prokurimi. Nga pasoja e këtij veprimi nuk është përmbushur qëllimin kryesor i këtij ligji në lidhje me mirepordorimi i fondeve publike, kursimin e tyre dhe sigurimin e trajtimit të barabartë dhe jo diskriminues të operatoreve ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, duke bërë që, vlera 27,244,160 lekë fonde buxhetore të mospërdoren me efektivitet dhe të mos kursehen në favor të buxhetit të shtetit.

-Për të meta te konstatuara në proces verbal nr. 6, datë 18.7.2014, për mos zbatim të detyrave sipas neneve nr. 9, 11 dhe 12 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”.

b. “Largim nga detyra”, përkatësisht për:

4. G.C., me detyrë **përgjegjës i zyrës së financës**, për shkeljet e mëposhtme:

-Per mos hartimin e “Regjistrit te aktiveve” me të gjitha të dhënat sipas kriterëve të përcaktuara në udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 kreu II pika 30.

-Per moszbatim të plotë të udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 kreu IV “*Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve*” si dhe “*Procesi i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësi*” pikat 95, 96 dhe 109, në kryerjen e inventarëve të aktiveve për vitet 2012 dhe 2013 si dhe mos vlerësimin dhe mos dokumentimin me fletë hyrje e dalje të aktiveve të cilësuar jashtë përdorimit.

-Për mos arkëtimin vlerën 943,400 lekë, nga të cilat 70,620 lekë diferencë qiraje nga viti 2012 dhe 872,780 lekë qira e pa paguar dhe kamatë vonesa për periudhën 1 Janar 2014 deri 30 Qershor 2014, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 529 datë 3.1.2012 “*Për përcaktimi e kriterëve të procedurës dhe mënyrën e dhënies me qira , enftiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore*”. Bazuar në nenin 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues” germa “d”, “dh”, “e” të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” për mos azhurnim të aseteve dhe mos vlerësimin dhe mos regjistrimin e pronave të Bashkisë në regjistra, në kontabilitet dhe pranë ZVRPP Burrel, mos derdhjen në afatin e përcaktuar në kontratë të detyrimit mujor të qirasë, mos kryerjen sistematikisht përlllogaritjen e kamatë vonesave dhe ndjekin derdhjen e tyre sipas rregullave financiare sipas dokumenteve të administruar.

-Për mos ndjekje të procedurave për ndërhyrje në rrugë ligjore, në të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e të gjithë debitorëve, duke u mjaftuar vetëm në kontabilizimin e shumave, bazuar në nenin 12 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” pikat “dh, e, ë, f”, konkretisht: *për gjoba e çdëmtime të vendosura para vitit 2000 në shumën 2,216,124 lekë për të cilët mungon dokumentacioni bazë i evidentimit si debitorë. për çdëmtime e gjoba në shumën 1,042,325 lekë vendosura sipas rekomandimeve të KLSH në vitin 2011.*

-Për mos kryerjen e regjistrimit te çeljes së fondeve nga të ardhurat, në momentin e miratimit të buxhetit apo të miratimit të financimit por në fund të periudhës, veprim në mospërputhje të plotë me kriteret e përcaktuara në kapitullin V klasa 7 të VKM 783 datë 22.11.2006.

-Për mos vlerësim dhe mos evidentim në kontabilitet te aseteve pronë e Bashkisë si dhe ato të transferuara me VKM “*Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Burrel*”.

-Për mos ndjekje të procedurave për ndërhyrje në rrugë ligjore, në të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e të gjithë debitorëve, duke u mjaftuar vetëm në njoftimin e personave, bazuar në

nenin 12 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” pikat “dh, e, ë, f”. Për mos ndjekjen dhe arkëtimin e debitorëve për vitin 2011 dhe 2012, në mos zbatim të nenit 4 dhe 17 të ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010.

-Për mos paraqitje si detyrime në bilancet kontabël për vitet 2011 e në vazhdim, shumat e pa arkëtuara (detyrimet vjetore) nga taksat vendore.

-Për mos llogaritje dhe programim për vitet 2012-2013 te kufirit monetar te mallrave dhe shërbimeve të ngjashëm të kërkuara dhe për pasojë është përdorur procedura “blerje me vlera të vogla”, veprim ky në kundërshtim me kërkesat e pikës 1, 2 të kreut VI-të, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

-Për mos kontabilizim dhe zbatim te pjesshëm te vlerave debitorë për rekomandimet e KLSH-së të dërguara për zbatim, në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për percaktimin e standarteve dhe te rregullave kontabël”, me nenin 10 të ligjit nr. 10279 dt 20.05.2010 “Për kundravajtjen administrative “ dhe me nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “ Kodi i Punes “, i ndryshuar.

-Për lejimin e pagesës për vlerën 330,000 lekë, për përfitim dieta nga futbollistët e ekipit Burrelit, pasi mungon dokumenti i hotelit me kasë elektronike, në kundërshtim me nënpikën 3.2 të VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjëset që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit”, sipas urdhër shpenzimeve nr. 44, datë 23.2.2012, nr. 150, datë 18.5.2012 dhe nr. 173, datë 14.6.2012.

-Për lejimin e pagesës për vlerën 156,500 lekë efekti financiar, për aktivitete social-kulturore (dreka) të paligjshme, në kundërshtim me VKM nr. 243, datë 15.05.1995 “Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja” të ndryshuar me VKM nr.258, datë 3.6.1999, me UMF nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, me VKM nr.472, datë 02.7.2011”Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore për vitin 2011”, sipas urdhër shpenzimit nr. 43, datë 14.2.2013, sipas urdhër shpenzimit nr. 249, datë 21.8.2012 dhe sipas urdhër shpenzimit nr. 152, datë 23.5.2012.

-Për lejimin e pagesës mbi organike të 2 punonjësve të policisë bashkiake, për periudhën 9-mujore të vitit 2012, për vlerën 666,000 lekë efekti financiar, në kundërshtim me VKM nr. 313, datë 01.07.2002 “Për përcaktimin e strukturës, të numrit të punonjësve dhe shpenzimeve buxhetore të policisë bashkiake” i ndryshuar.

c. “Kalimi në një detyrë të një klase më të ulët për një periudhë 1 vit”, përkatësisht për:

5. E.D. me detyrë përgjegjëse e zyrës së burimeve njerëzore, për shkeljet e mëposhtme:

-për mos zbatim të detyrave sipas neneve 12 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe rregulloren e funksionimit të aparatit të bashkisë, ne cilësinë e kryetares të komisionit për asgjësimin e vlerave materiale të konstatuara jashtë përdorimit.

-Për lejimin e largimit te punonjësve te administratës pa dorëzuar detyrën me proces verbal, ne kundërshtim me VKM nr. 360, datë 14.7.2000 “Dorëzimi dhe marrja e detyrës”.

-Për marrjen në punë te 6 punonjësve të policisë së bashkiake pa formimin në akademinë e rendit, ne kundërshtim me “Rregulloren e Brendshme “TIP” te Policisë së Bashkisë dhe Komunës”, të miratuar me urdhrin e përbashkët të dy ministrive, si Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe Ministria e Rendit Publik, Kreu III “Marrëdhëniet e Punës dhe Funksionet Organike, neni 11 “Përzgjedhja e kandidatëve, formimi dhe kualifikimi”, pika 5, pika 9.

-Për lejimin mbi organike te 2 policeve bashkiak, për periudhën 9-mujore të vitit 2012, çka ka krijuar një efekt financiar për vlerën 666,000 lekë, në kundërshtim me VKM nr. 313, datë

01.07.2002 “Për përcaktimin e strukturës, te numrit punonjësve dhe shpenzimeve buxhetore te policisë bashkiake” i ndryshuar.

-Për lejimin e krijimit te efektit financiar për vlerën gjithsejtë 10,122,080 lekë, që ka ndikuar negativisht në buxhetin e bashkisë, si rezultat i largimeve nga puna të disa punonjësve të bashkisë dhe njërive vartëse, për periudhën 2011-2014 dhe për 1 rast para vitit 2011, , ku nga ankimimet e këtyre punonjësve pranë gjykatave dhe shërbimit civil, rezulton se 17 punonjës kanë fituar të drejtën e pagës për periudhën e shkëputur dhe në disa raste dhe kthimin në punë, dhe për këtë nuk ka dalë përgjegjësia indirekte, në kundërshtim me udhëzimin nr. 4, datë 27.01.2011 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011” pika 6.1 ”Vendimet gjyqësore” dhe pika 62 e UMF nr. 2 datë 6.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

“Vërejtje me paralajmërim”, përkatësisht për:

6. V.B., me detyrë **K/Inspektore e INUV**, për shkeljet e mëposhtme:

-Për punë pa efektivitet të INUV, për periudhën e auditimit në zbatimin e dispozitat ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës brenda territorit nën juridiksionin e bashkisë.

-Për mungese bashkëpunimi me strukturat policore, për lirimin e hapësirave publike, lirimin e oborreve të shkollave, shembjen e mureve, lirimin e trotuareve, prishjen e kioskave, nga ndërtimet pa leje, në zbatim të nenit 4, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar.

-Për mos ushtrim te sanksioneve ligjore nga INUV, në zbatim te nenit 5 , 13 dhe 14 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar, per disa subjekte të evidentuara si ndërtime të paligjshme.

-Per mos marrjen e masave dhe mos lirimin e oborreve te shkollave “D.Hima” , “Pjeter Budi” dhe shkolla “28 Nentori” nga ndërtimet pa leje, ku INUV nuk ka vendosur gjoba dhe nuk ka vendim prishje, veprim në kundërshtim me nenin 5/b e d të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit”, me nenin 75 dhe 77 të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën” .

-Për mos vendosje gjoba dhe mos nxjerrje vendim prishje, për 3 subjektet të cilët janë ndërtuar pa leje, në zonën ku ka studime për objekte shumëkatëshe, veprim në kundërshtim me nenin 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit”.

-Për mos administrim te dokumentacionit që përdor i Inspektoriati Ndërtimor Urbanistik, vendime për prishje, vendimet për pezullim, vendim gjobe, etj, nuk janë trajtuar si letra me vlerë, nuk kanë numër serial, nuk protokollohen në zyrën e Bashkisë dhe nuk dërgohen në zyrën e financës që të kontabilizohen.

-Per mos inventarizim dhe mosdorëzim në zyrën e arkivit të dosjeve te INUV, në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat “ .

7. A.C., me detyrë **K/Inspektor të INUV**, për shkeljet e mëposhtme:

-Për pune të dobët dhe pa efektivitet ne veprimtarinë e INUV, për periudhën e auditimit në zbatimin e dispozitat ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës brenda territorit nën juridiksionin e bashkisë.

-Për mos ushtrim te sanksioneve ligjore nga INUV, në zbatim te nenit 5 , 13 dhe 14 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar, për disa subjekte të evidentuara si ndërtime të paligjshme.

-Për mos marrjen e masave dhe mos lirimin e oborreve te shkollave “D.Hima” , “Pjeter Budi” dhe shkolles “28 Nentori” nga ndërtimet pa leje, ku INUV nuk ka vendosur gjoba dhe nuk ka vendim prishje, veprim në kundërshtim me nenin 5/b e d të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit”, me nenin 75 dhe 77 të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën” .

-Për mos vendosje gjoba dhe mos nxjerrje vendim prishje, për 3 subjektet të cilët janë ndërtuar pa leje, në zonën ku ka studime për objekte shumëkatëshe, veprim në kundërshtim me nenin 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit”.

-Për mos inventarizim dhe mosdorëzim në zyrën e arkivit të dosjeve të INUV, në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

8. B.F., me detyrë **përgjegjës i policisë bashkiake**, për shkeljet e mëposhtme:

-Për punë të dobët dhe pa efektivitet të policisë bashkiake, për vitin 2012, 2013 dhe 2014.

-Për mos aplikim gjoba në të gjitha rastet, për vitin 2012, 2013 dhe 6 mujorin e parë të vitit 2014, por është mjaftuar disa gjoba për vlerën 99,700 lekë të cilat nuk janë arkëtuar në masën 50 %.

-Për mungese bashkëpunimi me zyrën e taksave vendore për licencimin e subjekteve të palicencuara dhe debitorë, madje edhe për subjekte me aktivitet në qendër të qytetit.

-Për mungese bashkëpunimi me zyrën e urbanistikes dhe INUV, për disiplinimin, prishjen dhe lirin e hapsirave publike, nga ndertimet pa leje.

Veprime që bien ndesh me kërkesat e ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”, me ndryshimet e miratuara me Ligjin nr. 8335, datë 23.04.1998 si dhe Kreut V, neni 13 “Detyrat e punonjësve të Policisë Bashkiake e të Komunës” të Rregullores së Brendshme “TIP” e Policisë së Bashkisë dhe Komunës, të miratuar me urdhrin e përbashkët të dy ministrive, si Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit si dhe Ministria e Rendit Publik si dhe rregullores së brendshme të kësaj bashkie.

9. S.Xh., në cilësinë e kryetares të komisionit asgjësimit për vitin 2012, për shkeljet e mëposhtme:

-Për mos zbatim të detyrave sipas neneve 12 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe rregulloren e funksionimit të aparatit të bashkisë, për asgjësimin e vlerave materiale të konstatuara jashtë përdorimit, sipas procesverbalit datë 1.4.2013 ka kryer asgjësimin pa përcaktuar listën e materialeve, mënyrën e asgjësimit dhe vendin e groposjes së mbeturinave në vlerën 1,243,181 lekë, (Objekte të llogarisë 218 në vlerën 564,395 lekë dhe - Objekte të llogarisë 327 në vlerën 678,786 lekë.).

-Për mos zbatim të kriterëve të udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 kreu IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve” “Inventarizimi i aktiveve” pikat 73 dhe 74 si dhe “Procesi i vlerësimit të aktiveve propozuara për dalje jashtë përdorimi” si dhe pikat 109, 110, pasi nuk është prerë fletëhyrje dhe fletëdalje për artikujt e asgjësuar si dhe paraqitet parregullsi në dokumentacionin dhe normativat e karburantit.

10. G.H., me detyrë **auditues i brendshëm i bashkisë**, për shkeljet e mëposhtme:

-Për mos efektivitet në punën audituese.

-Për mangësi dokumentare në dosjet e auditimit, pasi në asnjë rast nuk ka organizuar në mënyrë zyrtare dhe të dokumentuar një takim përmbyllës si dhe nuk ka komente të paraqitura në Raportin Final, në fund të trajtimit të gjetjeve mbasi nuk janë paraqitur vërejtje nga subjektit.

-Për mos ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve për auditimet e kryera.

-Për kryerjen e auditimeve formale, pasi nuk ka dëme me efekte financiare të zbuluara nga audituesi.

-Për mos respektim të afateve kohore midis njoftimit të subjektit dhe angazhimit të auditimit në kundërshtim me Manualin e Auditimit të Brendshëm, kapitulli III, pika 3.1.4, hapi 3:

-Për mos dokumentim në asnjë rast takimi fillestar duke mos respektuar udhëzimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm, kapitulli III, pika 3.1.4, hapi 3.

-Për mungesën në dosjet e subjekteve të audituara të vlerësimit riskut për fushat që do të auditohen sipas Formatit Standard 8 dhe rrjedhimisht nuk ka as diskutime me stafin e subjektit për të identifikuar plotësisht fushat e riskut që zgjidhet që në takimin fillestar, sipas MA, kapitulli III, pika 3.1.5, hapi 4.

11. B.H., juriste, për shkeljet e mëposhtme:

-Për lejimin e krijimit të efektit financiar për vlerën gjithsej 10,122,080 lekë, që ka ndikuar negativisht në buxhetin e bashkisë, si rezultat i largimeve nga puna të disa punonjësve të bashkisë dhe njësive vartëse, për periudhën 2011-2014 dhe për 1 rast para vitit 2011, ku nga ankimmimet e këtyre punonjësve pranë gjykatave dhe shërbimit civil, rezulton se 17 punonjës kanë fituar të drejtën e pagës për periudhën e shkëputur dhe në disa raste dhe kthimin në punë, dhe për këtë nuk ka dalë përgjegjësia indirekte, në kundërshtim me udhëzimin nr. 4, datë 27.01.2011 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011” pika 6.1 “Vendimet gjyqësore” dhe pika 62 e UMF nr. 2 datë 6.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

12. E.Gj., jurist, për shkeljet e mëposhtme:

-Për lejimin e krijimit të efektit financiar për vlerën gjithsejtë 10,122,080 lekë, që ka ndikuar negativisht në buxhetin e bashkisë, si rezultat i largimeve nga puna të disa punonjësve të bashkisë dhe njësive vartëse, për periudhën 2011-2014 dhe për 1 rast para vitit 2011, ku nga ankimmimet e këtyre punonjësve pranë gjykatave dhe shërbimit civil, rezulton se 17 punonjës kanë fituar të drejtën e pagës për periudhën e shkëputur dhe në disa raste dhe kthimin në punë, dhe për këtë nuk ka dalë përgjegjësia indirekte, në kundërshtim me udhëzimin nr. 4, datë 27.01.2011 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011” pika 6.1 “Vendimet gjyqësore” dhe pika 62 e UMF nr. 2 datë 6.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

VO; Për punonjësit e larguar nga bashkia, nuk propozohen masa disiplinore, pasi masa ndaj tyre është e ezauruar, përkatësisht:

1. **S.LI., ish-kryetar i Bashkisë Burrel,** larguar dhe banon jashtë shtetit.
 2. **M.S., ish-kryetar i KVO,** në tenderin e pastrimit të vitit 2009, larguar.
 3. **J.A., ish-përgjegjës i zyrës shërbimeve,** larguar.
 4. **N.K., ish-përgjegjës i zyrës shërbimeve,** larguar.
 5. **L.K., ish-supervizorë** firmës pastrimit shpk “Kreshnik”, larguar.
- Masa e propozuar nga ana jonë do të ishte “**Largim nga puna**”.

Për drejtuesit e mësipërm të njoftohet Departamenti i Administratës Publike për masat disiplinore me qëllim kryerjen e regjistrimeve të nevojshme në Regjistrin Qendror të Personelit.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Besim Bileri, Milo Pano dhe Luan Kuka më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtor i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Luljeta Nano, Sekretar i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT